



REPUBLIKA E SHOIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

Bordi

VENDIM

Nr. 99 , Datë 21.06.2019

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “POWER AND GAS OPERATIONS” PGO SH.P.K.,
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.06.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Power and Gas Operations” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 308 Prot., datë 23.04.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 71, datë 10.05.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Pas kësaj vendimarrje, me shkresën nr. 32/30 Prot., datë 10.05.2019, u bë njoftimi në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 308/1 Prot., datë 14.05.2019, iu dërgua subjektit njoftim për vendimin dhe kërkesa për plotësimin e mungesave të konstatuara në dokumentacion.
- Shoqëria “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 308/3, datë 28.05.2019, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e bordit të ERE- s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk

rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

• Aplikimi i shoqërisë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatimi dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Power and Gas Operations” PGO sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Adriatik BEGO